



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije- Ministry of Trade and Industry

Agjencia për Promovimin e Investimeve/ Agencija za promociju investicije / Investment Promotion Agency

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:					
PËR/ZA/TO:	Visar Duriqi-QKGH				
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Bajram Shala-Zyra për informim				
NGA/OD/FROM:	Valdrin Lluka - kryeshef i APIK-ut				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigjet në pyetjet e gazetarit				
Nr. i zyrës:	010	Lokacioni:	36 541	Data:	
Br. kancelarije:		Kucni:		Datum:	
Room No.:		Extension:		Date:	

I nderuar,

Agjencia për Promovimin e Investimeve në Kosovë (APIK) që vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI), e cila është e themeluar në gjysmën e dytë të vitit 2006, duke u mbështetur në Ligjit për investimet e huaja. Kjo agjenci ka për qëllim primar tërheqjen e investimeve nga jashtë, si dhe promovimin e Kosovës si vend atraktiv për investitorët dhe kompanitë e huaja.

Buxheti për vitin 2007 ka qenë në vlerë prej 117,044.90 euro, nga kjo vlerë;

Paga dhe mëditje----- 25,744.00
Mallra dhe shërbime 86,000.00

Nga kategoria mallra dhe shërbime janë shpenzuar 25,676.00 euro në botime dhe publikime që ka të bëjë në botimin e materialeve promovuese: CD-ve, broshurave, fletëpalosjeve, materiale të cilat iu janë shpërndarë investitorëve, zyrtarëve të cilët kanë marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare, institucioneve qeveritare vendore (Zyres së Kryeministrisë, si dhe ministrive të ndryshme), ndërsa 16,000.00 euro shërbime kontraktuese në botim të studimeve sektoriale, e që në total janë

shpenzuar për këtë vijë buxhetore 41,676,00 euro, që paraqet afër 50 për qind në kategorinë mallra dhe shërbime

Buxheti për vitin 2008 ka qenë në vlerë prej 318,483.00 euro,nga kjo vlerë;

Paga dhe mëditje25,233.00
Mallra dhe shërbime293,250.00

Nga kategoria mallra dhe shërbime:

Shërbime kontraktuese37,259.00
Botime dhe publikime10,000.00
Reklama dhe konkurse15,315.00

Gjithsejtë: 62,574.00

Në shërbimet kontraktuese në vlerë prej (37,259.00) studime sektoriale,organizim i konferencave dhe pjesëmarrja në këto konferenca

Buxheti për vitin 2009 ka qenë në vlerë prej 293,086.00 euro,nga kjo vlerë;

Paga dhe mëditje43,086.00
Mallra dhe shërbime250,000.00

Nga kategoria mallra dhe shërbime;

Shërbime kontraktuese.....141,677.00
Botime dhe publikime 47,656.00
Reklama dhe konkurse..... 47,462.00

Gjithsejtë: 236,815.00

Në shërbimet kontraktuese vlere prej (141,677.00) bëjnë pjesë mbi tetë studime sektoriale, organizimi dhe pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare, organizimi i B2B jashtë dhe brenda vendit. Sa i përket organizimit të konferencave jashtë vendit dhe organizimit të B2B-ve i është dhënë përparësi që të jenë bashkorganizatore institucionet joqeveritare, duke filluar prej Oda Ekonomike e Kosovës, Aleanca e Bizneseve të Kosovës, Oda Amerikane në Kosove, si dhe asociacione tjera me te vogla në tërë Kosovën.

Buxheti për vitin 2010 ka qenë në vlerë prej 296,082.00 euro,nga kjo vlerë;

Paga dhe mëditje55,402.00
Mallra dhe shërbime240,680.00

Nga kategoria mallra dhe shërbime;

Shërbime kontraktuese.....136,351.00
Botime dhe publikime 55,561.00
Reklama dhe konkurse..... 48,768.00

Gjithsejtë 240,680.00

Në shërbimet kontraktuese, në vlerë prej 136,351.00, bëjnë pjesë studimet sektoriale, organizimi konferencave dhe pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare, organizimi i B2B jashtë dhe brenda vendit. Edhe për këtë vit vlejnë i njëjti parim i bashkëpunimit me institucionet joqeveritare për pjesëmarrje në konferencat ndërkombëtare.

Buxheti për vitin 2011 ka qenë në vlerë prej 337,888.00 euro, nga kjo vlerë;

Paga dhe mëditje71,208.00
Mallra dhe shërbime266,680.00

Nga kategoria mallra dhe shërbime për;

Shërbime kontraktuese.....165,207.00
Botime dhe publikime 33,168.00
Reklama dhe konkurse..... 32,506.00

Gjithsejtë **230,871.00**

Parim i njëjtë si në vitin 2010 sa i përket shërbimeve kontraktuese.

Buxheti për vitin 2012 ka qenë në vlerë prej 279,113.00 euro, nga kjo vlerë;

Paga dhe mëditje64,113.00
Mallra dhe shërbime215,000.00

Nga kategoria mallra dhe shërbime për;

Shërbime kontraktuese..... 37,604.00
Botime dhe publikime 9,900.00
Reklama dhe konkurse..... 150.00

Gjithsejtë **47,654.00**

Për vitin 2012 është treguar pasqyra gjashtëmujore e shpenzimeve.

Për vitin 2012 nuk e kemi futur filmin promovues të CNN, i cili është lejuar me vendim të Qeverisë së Kosovës dhe i është paraparë një kosto prej 1 (një) milion euro. Nga kjo vlerë Qeveria është zotuar se do të ndajë 600,000.00 euro, ndërsa një pjesë mbulohet nga vija buxhetore e APIK-ut dhe një pjesë nga vijat buxhetore të MTI-së.

Deri në këtë gjashtëmujor për filmin promovues janë paguar 104,895.00 euro, sipas dinamikës së marrëveshjes në mes palëve kontraktuese.

APIK për të gjitha projektet e realizuara paraprakisht është bazuar në hulumtimet të cilat janë bërë për vendet potenciale për tërheqje të investimeve si dhe mbështetur në dokumentin strategjik të APIK (strategjia për tërheqjen e investimeve të huaja), dokumenti i cili identifikon sektorët strategjikë, vendet strategjike, politikat promovuese dhe veprimet të cilat duhet të ndërmerren dokument. Ky dokument është udhërrëfyes edhe për përcaktim të prioritetëve për PVPE.

Matjet statistikore janë çështje të cilat paraqesin vështirësi sepse efektet nuk janë të menjëhershme, por ne si institucion patjetër është dashur që edhe për raportim për institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare të gjejmë formë raportimi për matje të progresit apo për ndërrim të strategjisë promovuese. Forma më ideale ka qenë përcjellja e ardhjes dhe vendosjes së kompanive të huaja në Kosovë.

APIK ka të instaluar bazën e të dhënave për regjistrim dhe përcjellje të kompanive të huaja dhe raporton për institucionet vendore dhe ndërkombëtare për çdo kuartal vjetor.

Sa për ilustrim mund t'ju informojmë se në raport me vitin 2007 ka pasur një rritje progresive të kompanive të huaja dhe në vitin 2008 numri është rritur për 606 kompani , për vitin 2009 për 714, për vitin 2010 për 732 dhe për vitin 2011 për 677 kompani të huaja.

Si kriter tjetër i matjes është edhe kontakti i stafit me investitorët dhe kompanitë e huaja si dhe ndihmën të cilën e ofron APIK për investitorët e huaj si në dhënien e informatave ashtu edhe në mënyrën e ndihmesës për realizim të investimeve në Kosovë.

Me respekt,